

D E K R E T
Nr.682, datë 4.11.1993

PËR SHPËRNDARJEN E ARBITRAZHIT SHTETËROR

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozim të Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J :

Neni 1

Arbitrazhi shtetëror shpërndahet.

Mosmarrëveshjet pasurore ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore zgjidhen nga gjykata e rrethit.

Neni 2

Mosmarrëveshjet pasurore, në të cilat njëra nga palët është person juridik a fizik i huaj, zgjidhen nga gjykata e rrethit ose me arbitrazh vullnetar, kur në kontratë ose vetë palët kanë pranuar zgjidhjen me arbitrazh, të rregulluar përkatësisht nga legjislacioni shqiptar ose nga konventat ndërkombëtare përkatëse.

Neni 3

Mosmarrëveshjet që janë në shqyrtim, zgjidhen sipas dispozitave të këtij dekreti.

Neni 4

Ligji nr.7421, datë 14.11.1990 “Për Arbitrazhin Shtetëror”, shfuqizohet.

Neni 5

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

KUNDËRFIRMOHET
KRYEMINISTRI
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha

Miratuar me ligjin nr.7801, datë 2.3.1994 të Kuvendit Popullor.